



Pranuar / Dorezuar Priljeno / Prodato Received / Delivery	20.11.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	7039/2023		1/2



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1293/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtar, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1293/2023 të datës 17.11.2023 të parashtruar nga ankuesja

Komuna e Prishtinës, kundër Vendimit me numër Nr.02/KD dhe numër protokollit 1959/2023 të datës 15.09.2023, në çështjen juridike „Masë disiplinore“, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 20.11.2023 mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.1293/2023 të datës 17.10.2023 të parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja, e punësuar sipas Akt Emërimit me numër protokollit Nr.prot.910 të datës 11.06.2012 në pozitën e punës „Menaxhere e Komisionit Mjekësor“ në Departamentin e Invalidëve të Luftës dhe Familjeve të Dëshmorëve në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transferereve, më datë 17.10.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 6560/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër 02/KD dhe numër protokollit 1959/2023 të datës 15.09.2023, të Komisionit Disiplinor në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transferereve, përmes së cilit ankueses i është shqiptuar masa disiplinore „ndalim 40% i pagës për gjashtë (6) muaj“.

Në proces të shqyrtimit të ankesës nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.11.2023, ankuesja përmes shkresës së dërguar në e-mailin zyrtar ankesa.kpmschck@rks-gov.net e cila është protokolluar me numër të protokollit 7028/2023, ka tërhequr ankesën me numër

A.nr.1293/2023 të datës 17.10.2023, me arsyetimin se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, pas shqyrtimit të fakteve dhe rrethanave të reja më datë 08.11.2023 ka nxjerr Vendim me numër Nr.06-1/2023 përmes të cilit e ka anuluar Vendimin me numër 02/KD dhe numër protokollit 1959/2023 të datës 15.09.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve lidhur me shqiptimin e masës disiplinore „Ndalim 40% i pagës për gjashtë (6) muaj“, ndaj ankueses, andaj edhe tërheqja e kësaj ankese rrjedhë ngase kanë pushuar arsyet dhe objekti i shqyrtimit të ankesës meqenëse është anuluar vendimi i kontestuar nga vete institucioni.

Andaj, Kolegji i Këshillit pas pranimit të kërkesës me numër të protokollit 7028/2023 të ankueses për tërheqje nga ankesa, konstatoi plotësimin e kushtit ligjor për përfundimin e procedimit administrativ, siç parashihet me dispozitat e nenit 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë”, dhe si rrjedhojë në mbështetje të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrtës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi për përfundimin e procedimit administrative të filluar sipas ankesës me numër A.nr.1293/2023 të datës 17.10.2023 të ankueses Igballe Krasniqi, si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e Kryetares së Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi..

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1293/2023.

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore -GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuese.
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.